

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies
au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare e Kuvendit të Kosovës
Seanca nr.2002/21
Prishtinë,më 27 nëntor 2002,ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit,salla plenare

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi z.Nexhat Daci,kryetar i Kuvendit të Kosovës.
Kryesusi konstatoi numrin e deputetëve të pranishëm në seancë,gjithsej 68 dhe shpalli të hapur punët e saj.
Për këtë seancë ishte propozuar ky

REND I DITËS

- 1.Miratimi i rendit të ditës;
- 2.Procesverbali nga mbledhja e kaluar;
- 3.Shqyrtimi i parë i P/ligjit “Për Pyjet e Kosovës-2002/10”;
- 4.Shqyrtimi i dytë i P/ligjit “Për Tregtinë e Jashtme-2002/6”;
- 5.Rekomandimet e Këshillit Gjyqësor dhe të Prokurorisë për emrimin e gjyqëtarëve dhe prokurorëve;dhe
- 6.Parashrimi i pyetjeve.

1.Miratimi i rendit të ditës.

Kryesusi kërkoi nga deputetët që ta miratojnë rendin e ditës.

Bujar Dugolli: Kërkoi sqarim nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës lidhur me takimin që ishte mbajtur në Lucern të Zvicrës dhe rendit të ditës t’i shtohet edhe pika e vecantë :situata në arsimin e lartë,përkatësisht greva e studentëve e Universitetit të Priahinës.

Alush Gashi,tha se mbështet rendin e ditës,por ai kërkoi që në mos seancën e sotme,atëherë në njëren nga seancat e ardhshme të diskutohet për punën e Kuvendit,të Kryesisë,Sekretarisë së Kuvendit si dhe për punën e Qeverisë së Kosovës.

Ramadan Kelmendi,tha se deputetët e Kuvendit duhen të informohen nga Qeveria e Kosovës lidhur me Urdhëresën e PSSP-së nr.2002/26 se cka përmban ajo?
Ai kërkoi nga delegacionet e Kosovës që vizitojnë vendet e huaja,ta informojnë Kuvendin e Kosovës lidhur me rrëjedhën e tyre.

Ismajl Kurteshi,tha se kërkon nga Kryesia e Kuvendit që të kontaktojë me KFOR-in,UNMIK-un që të ndër marrin masa për pengimin e cenimit të teritorit të Kosovës dhe rrezikimin e jetës së qytetarëve tanë nga organet maqedonase,ku ditë më parë,ato kishin plagosur një vajzë nëntëvjeçare të një fshati të komunës së Gjilanit.
Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe diskutimi i vendimit të PSSP-së për monitorimin e Kuvendit të Kosovës nga OSBE-ja.

Muhamed Kelmendi,tha se monitorimi i Kuvendit të Kosovës nga OSBE-ja të cilën e ka caktuar PSSP është në kundërshtim me Kornizën Kushtetuese dhe Rregullorëne punës së Kuvendit,dhe se ai nuk ka bazë juridike.Qeveria nuk i ka raportar Kuvendit as për punën tre mujore as gjashtë mujore, gjë që është dashur ta bëjë,vazhdoi z.Kelmendi.
Ai propozoi që seancat plenare të Kuvendit të mos zgjasin vetëm një ditë,por të vazhdojnë punën nga dy-tri ditë, ngase duhet të debatohen problemet aktuale me të cilat po ballafaqohemi.

Besa Gaxheri,tha se e mbështet rendin e ditës,por shfaq shqetësimet e saja në lidhje me ekcesin që kishte ndodhur afër kufirit me IRJ të Maqedonisë.
Kryesusi,tha se i mbështet shqetësimet e deputetëve dhe së shpejti në rend të ditës së seancës plenare do të jetë një pikë e vecantë:Gjendja në Kosovë dhe veprimi i institucioneve të Kosovës.Shqyrtimi i parë i P/ligjit “Për Pyjet e Kosovës”tha kryesusi duhet të shtyhet,sepse propozuesi i tij sot nuk është i pranishëm,kurse për iniciativën rreth sqarimit të takimit në Lucern që e ngriti z. Dugolli,kryesusi tha se lidhur me te e ka informuar Kryesinë e Kuvendit dhe ajo informatë duhet t’ju shpërndahet të gjithë deputetëve.
Kryesusi konstatoi se është miratuar rendi i ditës dhe mund të procedohet me pikat e tjera.

2.Procesverbali nga seanca e kaluar.

Nuk pati vërejtje nga deputetët në procesverbalin e Seancës së kaluar dhe ai u miratua.

Hasan Meta shfaq shqetësimet lidhur me shtyrjen e shqyrtimit të parë të P/ligjit “Për Pyjet e Kosovës” dhe pyeti deri kur Kuvendi duhet të tolerojë që të bëhet peng i tekeve të individëve apo grupeve që nuk ia dojnë të mirën Kosovës dhe qytetarëve të saj.

Tomë Hajdaraj,tha se P/ligji në fjalë po zhagitet një kohë të gjatë dhe propozoi që Kuvendi t'i drejtohet ministrisë përkatëse që ta caktojë të autorizuarin e vet,i cili në seancën e ardhshme plenare do ta arsyetonte P/ligjin e propozuar para deputetëve të Kuvendit.

3.Shqyrtimi i dytë i P/ligjit”Për Aktivitet e Tregtisë me Jashtë-2002’6”.

Kryesusi,tha se para se të kalohet në shqyrtimine dytë të këtij P/ligji,komisionet e Kuvendit(i buxhetit,tregtisë dhe industrisë dhe ai komunitetve)duhet në ndërkohë-pauzë prej 30 minutash që t'i shqyrtojnë amendamentet e Qeverisë të cilat janë harmonizuar me Zyrën e këshilltarit juridik të PSSP-së dhe ato vërejtje që nuk janë harmonizuar,psataj të vazhdohet me shqyrtimin e dytë të tij.

Kryesusi,tha se gjatë pauzës komisionet i kanë shqyrtuar amendamentet e propozuara dhe mund të vazhdohet me shqyrtimin e dytë të P/ligjit.

Bajrush Xhemajli,tha se Komisioni për Tregti dhe Industri e ka shqyrtuar P/ligjin e Tregtisë së Jashtme dhe ka dhënë vlerësimine vet se është një P/ligj i kënaqshëm. Amendamentët e Qeverisë dhe të UNMIK-ut, që u janë shpërndarë sot,nuk i kemi shqyrtuar potenco i z.Xhemajli.UNMIK-u ka mundur që vërejtjet e veta t'i paraqesë në fazën përgatitore të P/ligjit e jo tani në fazën e shqyrtimit të dytë të tij,vazhdoi z.Xhemajli.Tani kjo është një ndërhyrje e vrazhdë,ku UNMIK-u ndërhyr me 29 komente,ka prekur 120 çështje në P/ligj që në fakt ai ndryshon nga verzioni që është miratuar herën e parë.Unë si deputet i këtij Kuvendi,vazhdoi z.Xhemajli nuk i pranojë ato komente të cilat tani i kanë sjellë në formë të amendamenteve,kurse është çështje e secilit deputet që të deklarohet lidhur me to.

Haki Shatri,tha se Komisioni për buxhet u takua gjatë pauzës dhe nuk i ka miratuar amendamentet e dorëzuara sot,për shkak se pranimi me vonesë dhe jashtë procedurës nuk mundësoi vlerësimin objektiv të tyre.Komisioni mori vendim që t'i propozojë Kuvendit që P/ligjin për shqyrtim ta miratoj me vërejtjet,propozimet,përkatësisht amendamentet e pranuar nga komisionet përkatëse të Kuvendit.

Fatmir Rexhepi shroi çështjen e përgjegjësisë së vonesës së miratimit të këtij P/ligji.Ky P/ligj,tha ai është në harmoni me kreun e 5 dhe paragrafët përcjellës ,5.6,5.7 të Kornizës Kushtetese.Ndërhyrja e UNMIK-ut dhe procedura e Zyrës ligjore e Zyrës së kryeministrit ,potenco i ai e kanë komplikuar punën dhe kërkoi që herave e tjera të ndërpritet ajo praktikë.

Sadudin Berisha,tha se Komisioni për të drejtat dhe ineresat e komuniteteve e ka shqyrtuar këtë P/ligj me 06.11.2002 dhe i ka dhënë rekomandimet e veta duke i mbështetur të gjitha amendamentet që i shqyrtojnë komisionet e Kuvendit.Sot,sërish Komisioni i ka rikonfirmuar qëndrimet e veta të miratuara më herët.

Hydajet Hyseni,tha se ka vërejtje se janë bërë shkelje të shumta procedurale.Amendamentet janë shpërndanë sot dhe kërkohet që sot të shqyrtohen ato!Janë shpërndarë tekste me amendamente të Zyrës ligjore të UNMIK-ut.Ato nuk jan

proceduar si amendamente,por si komente.Zyra ligjore e UNMIK-ut nuk është subjekt ligjvënës i Kuvendit.Ai propozoi që të procedohet sipas rregullorës së punë së Kuvendit,që të shqyrtohen amendamentet e aprovuara nga komisionet e Kuvendit,kurse shqyrtimi i tretë i P/ligjit si tërësi pasi të inkorporohen edhe amendamentet në tekstin e spastruar dhe i kompletuar të miratohet në Kuvend.

Bujar Dugolli,tha se qëndrimi i grupit parlamentar i AAK-së është që të mos votohet për e Zyrës ligjore të PSSP-së pa u shqyrtuar nëpër komisionet përkatëse të Kuvendit.Për këtë,vazhdoi z.Dugolli duhen të deklarohen kryetarët e komisioneve dhe të dihet se për cka po votohet.

Kryesusi i hodhi në votim amendamentet e komisioneve kryesore dhe funksionale të Kuvendit të Kosovës që e kanë shqyrtuar P/ligjin dhe amendamentet e Qeverisë së Kosovës të harmonizuaara me Zyrën ligjore të UNMIK-ut, në atë P/ligj.

Rezultati ishte me sa vijon:

Preambula,paragrafi i dytë-refuzohet.

Neni 1.2(propozim i komisioneve)- miratohet.

Neni 1.2(propozim i Qeverisë)-refuzohet.

Neni 2 paragrafi 4(propozim i Qeverisë)-refuzohet.

Neni 2 paragrafi 5(propozim i Qeverisë)-refuzohet.

Neni 2 paragrafi 7(propozim i Qeverisë)-refuzohet.

Neni 2 paragrafi 7(propozim i UNMIK-ut)-refuzohet.

Neni 2 paragrafi 10(propozim i Qeverisë)-refuzohet.

Neni 2.paragrafi 12(propozim i Qeverisë)-refuzohet.

Neni2 paragrafi 14 (propozim i komisioneve)-miratohet.

Neni 2 paragrafi 16(propozim i UNMIK-ut)-refuzohet.

Neni 2 paragrafi 16(propozim i Qeverisë)-refuzohet.

Neni 2 paragrafi 19(propozim i Qeverisë)-refuzohet.

Neni 2 paragrafi 22(ropozim i Qeverisë)-refuzohet.

Neni 2 paragrafi 22,(c)(propozim i Qeverisë)-refuzohet.

Neni 2 paragrafi 23(propozimi Qeverisë)-refuzohet.

Neni 2 paragrafi 26(propozim i Qeverisë)-refuzohet.

Neni 2 paragrafi 29(a),(propozim i Qeverisë)-refuzohet.

Neni 2 paragrafi 29(propozim i komisioneve)-miratohet.

Neni 2 paragrafi 32(propozim i komisioneve)-miratohet.

Neni 3.1 (propozim i komisioneve)-miratohet.

Neni 3.2 (propozimi komisioneve)-miratohet.

Neni 4.1 (propozim i Qeverisë)-refuzohet.

Neni 4.1nen i ri (propozim i Qeverisë)-refuzohet.

Neni 5.2 (propozim i Qeverisë)-refuzohet.

Neni 6.2 (propozim i Qeverisë)-refuzohet.

Neni 6.4 nen i ri (propozim i komisioneve)-miratohet.

Neni 7.2 (propozim i komisioneve)-miratohet.

Neni 7.3 (propozim i komisioneve_)-miratohet.

Neni 8.1 (propozim i Qeverisë)-refuzohet.
 Neni 9.1 (propozim i Qeverisë)-refuzohet.
 Neni 10 (propozimi Qeverisë)-refuzohet.
 Neni 11(propozim i Qeverisë)-refuzohet.
 Neni 12.1 (propozim i Qeverisë)-refuzohet.
 Neni 12.3 (propozim i komisioneve)-miratohet.
 Neni 12.4 (propozim i Qeverisë)-refuzohet.
 Neni 13.1(propozim i Qeverisë)-refuzohet.
 Neni 13.2 (pepozim i komisioneve)-miratohet.
 Neni 13.3 (propozim i Qeverisë)-refuzohet.
 Neni 14.1 9propozim i Qeverisë)-refuzohet.
 Neni 14.3(propozim i komisioneve)-miratohet.
 Neni 16.1(propozim i Qeverisë)-refuzohet.
 Neni 21.2 (propozim i Qeverisë)-refuzohet.
 Neni 23.1 (propozim i Qeverisë)-refuzohet.
 Neni 24.1 (propozim i Qeverisë)-refuzohet.
 Neni 25.1 (propozim i Qeverisë)-refuzohet.
 Neni 26 (propozim i Qeverisë)-refuzohet.
 Neni 27 (propozim i komisionev)-miraatohet.
 Neni 28 (propozimi i Qeverisë)-refuzohet.
 Neni 31.1 (propozim i Qeverisë)-refuzohet.
 Neni 32 (propozim i Qeverisë)-refuzohet.
 Neni 33.1 (propozim i Qeverisë)-refuzohet.
 Neni 33.2 (pepozim i Qeverisë)-refuzohet.
 Neni 34.2 (propozim i Qeverisë)-refuzohet.
 Neni 34.3 (propozim i Qeverisë)-refuzohet.
 Neni 35 (propozim i komisioneve)-miratohet.
 Neni 39 (propozim i Qeverisë)-refuzohet.
 Neni 46 (propozim i komisioneve)-miratohet.
 Neni 47 (propozim i qeverisë)-refuzohet.
 Neni 49 (prpozim i Qeverisë)-refuzohet.
 Neni 49 (propozim i komisioneve)-miratohet.
 Neni 50 (propozim i Qeverisë)-refuzohet.
 Neni 51(propozim i komisioneve)-miratohet.
 Neni 52 (propozim i Qeverisë)-refuzohet.
 Neni 52 (propozim i komisioneve)-miratohet.P.S.ky nen është dhënë në katër versione dhe është lënë që të harmonizohen në një verzion më të përshtatshëm.

Pas shqyrtimit të amendamenteve një nga një,kryesusi e hodhi në votim P/ligjin në tërsi me amendamentet e miratuara dhe rezultati ishte me sa vijon:

Për-----64,
 Kundër---0,dhe
 Abstenime-1.

Kryesusi konstatoi se u miratua Ligji “Për Aktivitet e Tregtisë me Jashtë”.

4.Rekomandimet Këshillit Gjyqësorë dhe të Prokurorisë për emrimin e gjyqëtarëve dhe prokurorëve.

Kryesusi,tha se në bazë të konsultimeve në Kryesi,me Komisionin përkatës të Kuvendit dhe të Këshillit,është një propozim që të votohet emër për emër për cdo të rekomanduar.

Sabile Basha,shprehi shqetësimet e saja lidhur me mënyrën e rekomandimit të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë.Ajo,tha se biografia e të rekomandurëve nuk është e plotë dhe në shumtën e rasteve nuk dihet se ku kanë punuar ata deri në vitin 1999.Ajo propozoi që mos t'i jipet shansi ricidivëve të cilët kanë ushtruar masa diskriminuese ndaj qytetarëve të Kosovës.

Nekibe Kelmendi,tha se gjatë votimit duhet të jemi të matur se kush do të jetë bartës i funksionit të gjyqëtarit.Cështja e gjyqësisë,vazhdoi ajo është e rezervuar për PSSP-në.Ai ka nxjerrë Rreguloren me kriteret për emrimin e gjyqtarëve.Kuvendi nuk i emron gjyqtarët,por jep vetëm një pëlqim formalo-juridik.Ajo ishte e mendimit se nuk duhet t'i jipet pëlqimi për ata gjyqtarë dhe prokurorë të cilët kanë injoruar rregulloret dhe dokumentet e UNMIK-ut në Kosovë.Të gjithë ata që kanë gjykuar në gjykatat paralele pas vendosjes së UNMIK-ut nuk duhet të emrohen në funksione të gjyqëtrëve dhe prokurorëve,përfundoi znj.Kelmendi.

Hydajet Hyseni shtroi cështjet procedurale rreth emrimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe bëri një interpretim të Kornizës Kushtetuese e cila rregullon këtë materie.Kryesia e Kuvendit,vazhdoi z.Hyseni ka kërkuar një informatë të plotë nga Këshilli për kandidatët e rekomanduar,por ende nuk ka informatë të tillë,andaj nuk mund të votohet pa pasur informacione të nevojshme.Ka raste që janë refuzuar kandidatët të cilët kanë qenë të denuar në proceset e montuara politike edhe pse i kanë plotësuar kushtet për ato vende.Ata që kanë shkelur ligjin dhe kanë gjykuar në bazë të instruksioneve të komiteteve,nuk kanë të drejtë morale që përsëri të kërkojnë që të ushtrojnë të njejtin funksion,sepse e kanë shkelur profesionin e tyre,potenco i z.Hyseni.Ai propozoi që Kuvendi të mos e aprovoj listën si tërësi,por të kërkoj nga Këshilli Gjyqësor dhe Prokurial që të respektojë procedurat dhe ta informojë Kuvendin me të gjitha të dhënat që janë kërkuar.

Ramadan Kelmendi,tha se në seancën e kaluar është kërkuar që të përgatitet një informatë e plotë me biografinë e secilit kandidat në bazë të së cilës deputetët mund të votojnë,por një gjë e tillë nuk është bërë.Z. Kelmendi diskutoi për disa kandidatë me emra konkretë të cilët kanë zbatuar ligjet diskriminuese gjatë kohës së ish-pushtetit serb në Kosovë.Diskutimi i plotë i z.Kelmendi i është bashkangjitur transkriptit.

Bujar Dugolli,tha se është dashur që deputetët në këtë seancë t'i kenë biografitë e të rekomanduarëve,por një gjë e tillë nuk është bërë.Ai,tha se është një problem në mes Këshillit të Gjyqtarëve dhe të Prokurorisë dhe Kuvendit të Kosovës.Këshilli i fshehë biografitë e të rekomanduarëve,dhe prapa tyre fshihet dicka tjetër.Në këtë seancë nuk mund të votohet për ato rekomandime,përfundoi z.Dugolli.

Muhamed Kelmendi,tha se janë kërkuar të gjitha informacionet për kandidatët e rekomanduar dhe ata të refuzuar se ku kanë punuar,ku janë aktualisht dhe çfarë shkollimi kanë kryer? Këshilli Prokurial i ka të gjitha informacionet për secilin vec e vec.Pa informata të detajizuara për secilin,për biografinë e tij,deputetët nuk mundën të votojnë përfundoi z.Kelmendi.

Berat Luzha,tha se Kuvendi i Kosovës nuk është organ i cili duhet të jep vetëm pëlqime formale.Në mesin e të rekomanduarëve,vazhdoi z.Luzha ka edhe asi kandidatë të cilët kanë denuar njerzë në bazë të urdhërave politike dhe kanë ndrruar përkatësinë e tyre etnike në bazë të nevojave të kohës.

Hilmo Kandi,tha se i mbështet parafolësit e tij për mos votimin e rekomandimit të Këshillit Prokurial.Këtu askush nuk ka asgjë kundër askujt,por jemi,vazhdoi z.Kandi kundër atyre të cilët i janë bashkangjitur terrorit,vrasjeve dhe gjithë asaj që ka ndodhur në Kosovë,të cilët edhe sot,në mënyrë shumë të organizuar veprojnë nga një qendër dhe i bllokojnë institucionet e Kosovës.Në rekomandimet e Këshillit Prokurial,potenco i z.Kandi janë 14 serbë dhe vetëm 1 boshnjak!

Ismajl Kurteshi,tha se ka tendenca për ta instrumentalizuar Kuvendin e Kosovës dhe shpesh po ndodh që Kuvendi të vëhet para akteve të kryera.Në emër të ngutisë,vazhdoi z.Kurteshi kërkohet që të votojmë për ata kandidatë për të cilët nuk dijmë se a e meritojnë të votohen dhe në këtë formë tentohet të legjitimohet një regjim represiv i cili është mbajtur nga njerzë të papërgjegjshëm.

Lirak Celaj shprehu shqetësimet e tij lidhur me biografinë e kandidatëve dhe propozoi që të shpallen publikisht emrat e tyre nëpër komuna,në mënyrë që qytetarët të kenë mundësinë t'i sjellin informacione për ta komisionit përkatës të Kuvendit,i cili duhet t'i shqyrtojë ato dhe pastaj të votohet në Kuvend.

Sadik Idrizi,tha se kjo çështje nuk mund të kryhet nëse nuk fillon me gjëra konkrete.Mënyra se si ka filluar,vazhdoi ai,me argumente dhe kundërargumente do të zgjas shumë kohë.Duhet të të punohet sipas procedurës,potenco i ai dhe të respektohen rekomandimet e Këshillit Gjyqësor dhe Prokurial.

Kryesusi,tha se në bazë të diskutimeve dhe sygjërimeve të deputetëve,komisioni përkatës i Kuvendit duhet t'i kërkojë informatat dhe materialet e nevojshme.

Kryesusi këtë formulim e hodhi në votim.Rezultati ishte:

Për -----të gjithë deputetët,

Kundër ----asnjë,dhe

Abstenime---asnjë.

Kryesusi tha se seanca e ardhshme plenare e Kuvendit të Kosovës do të mbahet më 4 dhjetor 2002.

Seanca plenare përfundoi punimet në orën 12.55.

Sekretaria e Kuvendit

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,
akademik Nexhat Daci